
**THE ROLE OF THE INTERNATIONAL COMMUNITY IN STRENGTHENING THE
STATE INSTITUTIONS IN KOSOVO**

Bujar Daki

South East European University, Republic of Macedonia, bujarshdaki@hotmail.com

Jonuz Abdullahi

South East European University, Republic of Macedonia, j.abdullahi@seeu.edu.mk

Abstract: Building accountable and strong state institutions in the Balkans has become a real concern for the International Community, which is led by the European Union aspiration for enlargement, and represents a challenge for the newly elected governments in the region. This can be confirmed if we go through the European Commission progress reports for the Balkan countries, where many areas of governance remain unimproved for a long time now. The real intention behind this concern lies in finding the proper modalities for reaching good governance. Therefore there is a strong International presence in the region which closely monitors and advises the governments in their decision making processes.

In the other hand, we are all aware that the prolonged transition period of the entire Balkan region, and especially in Kosovo carries behind many problems from the past which have to do with nationalism, corruption, organized crime, politicization of the public administration, privatization, thus there is a need for strengthening the state democratic institutions that deal with rule of law, efficient public administration and functional democracy. All these concerns minimize the efforts for establishing strong state institutions that will combat such deviant activities, and will bring order and hope among the citizens of the respected countries.

In this regard we are going to analyze the role of the civil society, which is a monitoring tool in the process of policymaking, plays the function of a corrector of state institutions and has its impact on good governance. Moreover, we are going to explain the importance of financing and supporting the capacity building of these organizations, their monitoring and reporting projects, which can become a key for reforming the public administration during the transition period and making it an accountable service for its citizens.

For reaching the desired results we are going to use descriptive methodologies such as content analyses, comparative methods, as well as data analysis from previous researches on this field. The findings from this research paper should be able to address the many questions which have emerged due to the prolonged transition, which are mainly caused by old political mentality of the new Balkan politicians.

Keywords: State Institutions, Kosovo, democracy, international community, civil society.

**ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE NË FORCIMIN E
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË KOSOVË**

Bujar Daki

South East European University, bujarshdaki@hotmail.com

Jonuz Abdullahi

South East European University, j.abdullahi@seeu.edu.mk

Abstrakt: Ndërtimi i institucioneve të përgjegjshme dhe të forta shtetërore në Ballkan është bërë një shqetësim i vërtetë për bashkësinë ndërkombëtare, e cila udhëhiqet nga aspirata e Bashkimit Evropian për zgjerim dhe paraqet një sfidë për qeveritë e reja të zgjedhura në rajon. Kjo më së miri mund të konfirmohet gjatë shqyrtimit të raporteve të progresit të Komisionit Evropian për vendet e Ballkanit, ku shumë fusha të qeverisjes mbeten të pa përmirësuara për një kohë të gjatë. Synimi i vërtetë pas këtij shqetësimi qëndron në gjetjen e modaliteteve të duhura për arritjen e qeverisjes së mirë në këto shtete. Për këtë arsye edhe ekziston një prani e fortë ndërkombëtare në rajon, e cila vëzhgon nga afër dhe këshillon qeveritë gjatë proceseve të tyre të vendimmarrjes.

Në anën tjetër, të gjithë jemi të vetëdijshëm se periudha e gjatë e tranzicionit në rajonin e Ballkanit dhe veçanërisht në Kosovë mbart shumë probleme nga e kaluara që kanë të bëjnë me nacionalizmin, korrupsionin, krimin e organizuar, politizimin e administratës publike, privatizimin, kështu që ekziston nevoja për forcimin e institucioneve shtetërore demokratike që merren me sundimin e ligjit, administratën publike efikase dhe demokracinë funksionale. Të gjitha këto shqetësime minimizojnë përpjekjet për krijimin e institucioneve të forta shtetërore që do të luftojnë aktivitetet e tilla devijante dhe do të sjellin rend dhe shpresë në mesin e qytetarëve të vendeve të cekura.

Në kuadër të këtij punimi do të analizojmë ndikimin e faktorit ndërkombëtar dhe rolin e shoqërisë civile, e cila është një mjet monitorimi në procesin e hartimit të politikave, luan funksionin e një korrektori të institucioneve shtetërore dhe ka ndikimin e saj në qeverisjen e mirë. Për më tepër, ne do të shpjegojmë rëndësinë e financimit dhe mbështetjen e ngritjes së kapaciteteve të këtyre organizatave, projekteve të tyre të monitorimit dhe raportimit, të cilat mund të bëhen çelës për reformimin e administratës publike gjatë periudhës së tranzicionit, duke e bërë atë një shërbim të përgjegjshëm për qytetarët e saj.

Për arritjen e rezultateve të dëshiruara do të përdorim metodologji të ndryshme deskriptive siç janë analiza e përmbajtjes, më pastaj përdorimin e metodave krahasuese, si dhe analizë të të dhënave nga hulumtimet paraprake në këtë fushë. Gjetjet nga ky hulumtim duhet të trajtojnë shumë çështje që kanë ndodhur si pasojë e problemeve të tranzicionit, të cilat janë shkaktuar kryesisht nga mentaliteti i vjetër politik i politikanëve të rinj ballkanik.

Fjalët kyçe: Institucionet shtetërore, Kosova, demokracia, bashkësia ndërkombëtare, shoqëria civile.

HYRJE

Ndryshimet politike dhe shoqërore në rajonin e Ballkanit Perëndimor rezultuan me krijimin e shteteve të reja, të cilat për një kohë të gjatë gjenden në një periudhë të tranzicionit, kryesisht me qëllim të përafritimit me vlerat të cilat do të mundësonin aderim në Bashkimin Evropian dhe krijimin e shtetit modern dhe ekonomikisht të fortë. Mirëpo, ky tranzicion nuk rezultoi të jetë tejet pozitiv, kryesisht nga shkaku se aktorët të cilët udhëhoqën këtë proces nuk ishin të përgatitur dhe të aftë, dhe si pasojë u krijuan institucione shtetërore të dobëta, një ekonomi e pazhvilluar me një administratë publike jo-profesionale dhe politikisht të varur, dhe e gjithë kjo solli një zhgënjim të madh të popullatës ndaj institucioneve shtetërore që proklamohen të jenë demokratike. Sipas Huntigtonit, demokracia nuk është vetëm liri e mendimit, e drejta për të zhvilluar zgjedhje e kështu me radhë. Ajo është sundim i ligjit. Pa zbatimin e barabartë të ligjit demokracia është e vdekur.³³⁴ Në rastin e Kosovës, jo çdoherë janë respektuar normat demokratike në ushtrimin e pushtetit, prandaj edhe kemi situatë të tillë të ashpër politike në vend, ku etiketimet për keqpërdorime dhe presione të ndryshme nga ana e pushtetit gjithnjë janë prezent.

Nga ana tjetër, këto procese demokratike gjatë periudhës së tranzicionit kërkojnë një trajtim relevant shkencor-hulumtues në mënyrë që këto fenomene të trajtohen në kohë dhe të jepen përgjigje konkrete në pyetjet të cilat janë të rëndësishme për sa i përket ndodhive politiko-shoqërore në këto vende.

Në sajë të kësaj, në këtë punim hulumtues shkencor paraqitet një pasqyrë e zhvillimeve politike dhe ndryshimeve shoqërore në Kosovë, duke u ndalur tek ndërtimi i institucioneve shtetërore nga aktorët vendor, problematikat përcjellëse të këtij procesi dhe roli i faktorit ndërkombëtar si mbështetës dhe lehtësues i zhvillimit institucional, i cili kryesisht realizohet përmes përkrahjes së vazhdueshme direkte dhe indirekte të sektorit civil, i cili luan rolin e monitoruesit dhe korrigjuesit të aparatit shtetëror. Mirëpo, shtrohet pyetja se sa është i zhvilluar sektori civil në Kosovë dhe a disponon me resurset e nevojshme profesionale dhe kadrovike që të jep shtytje forcimit të kapaciteteve institucionale dhe atyre të llogaridhënies, duke ditur se vetëm një shoqëri e fuqizuar civile mund të luajë rol të rëndësishëm për të garantuar mbështetjen e parimeve të dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat e personave që u përkasin pakicave.³³⁵

Ekzistojnë hulumtime të shumta nga shumë autor vendor dhe ndërkombëtar të cilët janë marrë me problematikën e kapacitetit politik dhe shtet-formues të vendit, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe procesit të politikbërjes në shtetet e reja siç është Kosova. Andaj, në sajë të analizave paraprake, duke u bazuar kryesisht në teorinë e Francis Fukujamës mbi ndërtimin e shtetit dhe institucioneve shtetërore, por edhe të studuesve tjerë vendor dhe atyre ndërkombëtar, do të japim këndvështrimin tonë mbi çështjen e ndërtimit të institucioneve shtetërore në Kosovë, pjesëmarrjen e shoqërisë civile në këtë proces dhe rolin e organizatave ndërkombëtare si ndihmës i vazhdueshëm i këtij zhvillimi.

KONTEKSTI POLITIK NË KOSOVË

Pavarësisht nga orientimi i përgjithshëm pro-reformator i qeverisë dhe shumicës së mjaftueshme parlamentare, situata politike vazhdon të jetë e rënduar. Vështirësitë me të cilat ballafaqohet Kosova, që janë të përbashkëta me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, përfshijnë kulturën e pabarabartë të dialogut politik dhe zhvillimit të konsensusit. Këto vështirësi kanë rezultuar në kriza të kohëpaskohshme politike.³³⁶ Bllokimi i kuvendit dhe protestat e dhunshme kundër qeverisë e kanë vështirësuar edhe më tej funksionimin e shtetit në përgjithësi.

³³⁴ Samuel Huntington, Vala e tretë, AIIS, 2011, Tiranë, f.237

³³⁵ Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim, Udhëzime mbi mbështetjen e Be-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit 2014-2020, Bashkimi Evropian

³³⁶ Dokument i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Strategji për Kosovën, Tetor 2016, F.12

Procesi i integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian është një proces i ndërlikuar e kompleks që kërkon përkushtim dhe përbushjen e kriterëve të shumta dhe arritjeve të standardeve të kërkuara. Arsyeja kryesore që po i shtyn qeveritë drejt aplikimit për anëtarësim në BE, është arritja e nivelit të lartë të demokracisë, të arriturat ekonomiko, mirëqenia sociale të një shteti evropian. Mirëpo, jo rrallë pas kësaj aspirate fshihen edhe përfitimet e manipulimet politike nga partitë apo qeveritë e shteteve kandidatë, të cilat e shfrytëzojnë procesin e integritimit për qëllime të caktuara politike. Bashkimi Evropian është prezent në këtë rajon në forma të ndryshme, duke përkrahur fuqishëm përpjekjet e tyre për integrim në BE. Megjithatë, mungesa e një politike konsistente të BE-së karshi Evropës juglindore apo Ballkanit perëndimor siç njihet edhe ndryshe, por edhe mosmarrëveshjet e ndryshme ndërmjet vet shteteve ballkanike, ka bërë që procesi i integritimit të varet si nga faktorët e brendshëm ashtu edhe nga ato të jashtëm.³³⁷ Kriza permanente politike, e cila është krijuar në një ngërç politik ka rënduar ndjeshëm funksionimin e institucioneve shtetërore, reformimin e tyre në bazë të rekomandimeve të Komisionit Evropian. Ndihma e institucioneve ndërkombëtare, siç është EULEX-i dhe zyra e Bashkimit Evropian në mënyrë të vazhdueshme ndihmojnë procesin politik në vend, përmes ekspertëve dhe lehtësuesve nga kori diplomatik të akredituar në Kosovë. Dialogu politik me Serbinë, krijimi i Gjykatës Speciale dhe demarkacioni i kufirit me Malin e Zi janë disa nga sfidat me të cilët lidhshipi Kosovar duhet përballur.

NDËRTIMI I INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE REFORMA INSTITUCIONALE

Kur i referohemi konceptit “ndërtimi i institucioneve shtetërore”, nënkuptohet parapërgatitjet për formimin e institucioneve, krijimin e kushteve optimale për funksionimin e tyre në një mjedis të dalë nga lufta, duke pasur parasysh rregullimin e shtetit në suaza të njohjes ndërkombëtare dhe regulativës së re, duke mos mënjanuar këtu edhe zhvillimet politike që kanë ndodhur në Kosovë dhe zhvillimet pozitive që do të duhet të ndodhin në kontekst të caktuar. Ndërtimi dhe funksionimi i institucioneve publike të suksesshme është një sfidë shumëvjeçare dhe afatgjatë për qeveritë, madje edhe nën rrethana ideale. Kompleksiteti i kësaj sfide vështirësohet nga kushtet e paqëndrueshme të krijuara në mjedise të brishta dhe të prekura nga konflikti, ku preket siguria njerëzore, kohezioni social, stabiliteti politik dhe aktiviteti ekonomik. Këto vende përballesh me sfida gjatë ndërtimit të institucioneve, pengesa dhe dështime. Megjithatë, pavarësisht kësaj, disa institucione dhe organizata arrijnë në mënyrë efektive të ofrojnë rezultate, të fitojnë legjitimitet në sytë e qytetarëve dhe të krijojnë vlera pozitive në këto vende.

Ndërtimi i institucioneve është një proces dinamik, jo-linear që lëviz në përshtatje dhe nisje dhe shpesh është i reversibil. Për të përqafuar realitetin e ndryshimit institucional, partnerët e zhvillimit duhet të jenë të përgatitur për të shtuar fleksibilitet në ndryshimin e mirëfilltë dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e agjencive nga ndryshimet negative. Është e domosdoshme ndjekja oportune e momenteve dhe kampionëve të reformës, por duhet të shoqërohet me partneritete të qëndrueshme dhe rritje për suksesin afatgjatë dhe ndryshimin e qëndrueshëm.³³⁸

Një nga qëllimet e qarta të studimit tonë ishte të kuptojmë faktorët e përbashkët shkaktarë, që bazohen në ndërtimin e suksesshëm të institucioneve, në mënyrë që të sigurojnë bazën për njohuri operationale të synuara për politikën dhe programet në lidhje me reformën institucionale. Sipas Francis Fukuyama, organizatat më efektive janë padyshim ato të drejtuara nga individë shumë të aftë që kanë një hapësirë të gjerë veprimi dhe që përballesh me pak kontrolle institucionale zyrtare.³³⁹ Kjo ka të bëjë shumë kur bëhet fjalë për një shtet i cili është kushtimisht thënë nën monitorim të huaj, pasi që gjithnjë sipas Fukujamës, qeverisja e dobët kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvlerësimin e respektit të komunitetit ndërkombëtar për sovranitetin e një vendi. Nga kjo mund të konstatojmë se ndërtimi i administratës shtetërore efikase është thelbi i formimit të institucioneve të pavarura dhe profesionale në Kosovë dhe e cila mund ta risë imazhin e vendit karshi faktorit ndërkombëtar.

SEKTORI CIVIL

Një studim i realizuar nga Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile për vitin 2016³⁴⁰, tregon se shoqëria civile në Kosovë ka pasur një ndikim të theksuar në demokratizimin e vendit edhe atë duke bërë presion për transparencë dhe llogaridhënie të institucioneve publike, dhe duke kontribuar me ekspertizë nga organizata të specializuara në fusha të ndryshme. Gjithnjë sipas këtij studimi sektori civil është shumë aktiv në kërkesën për transparencë dhe llogaridhënie, sundim të ligjit, barazi gjinore dhe në procesin e integritimit evropian. Për realizimin e programeve si

³³⁷ Konrad Adenauer Stiftung, Kosova dhe marrëveshja e asocim stabilizimit, Prishtinë, 2013, f.2

³³⁸ Naazneen H. Barma, Elisabeth Huybens, and Lorena Viñuela (eds.) Institutions Taking Root: Building State Capacity in Challenging Contexts. Washington DC: World Bank, 2014.

³³⁹ Francis Fukuyama, Ndërtimi i shtetit, AIIS, Tiranë 2010, f.116

³⁴⁰ Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016, f.80

dhe të projekteve të kontraktuara, gjithsesi se këtyre organizatave ju nevojitet edhe mbështetje politike dhe financiare nga faktori ndërkombëtar. Një e mirë që bashkësia ndërkombëtare mund t'u ofrojë organizatave të ndryshme nga shoqëria civile është një shkallë më e madhe e stabilitetit dhe vazhdimësisë në programim dhe staf, së bashku me angazhim më të vendosur dhe të vazhdueshëm nga ana e tyre. Sipas studimit të mësipërm, vlen të theksohet se donatorët e huaj japin pjesën më të madhe të financimit të sektorit civil, për dallim nga fondet publike të cilat janë të dedikuara për këtë sektor. Kjo është shumë domethënëse ngase edhe ndikimet dhe ndërhyrjet në realizimin e projekteve janë më të vogla, kur bëhet fjalë për donatorët e huaj, për dalim nga ata të fondeve publike vendore. Sipas studimit në fjalë organizatat qytetare që marrin fonde publike raportojnë ndërhyrje më të madhe krahasuar me ato që marrin fonde të huaja. Sektori civil falë faktorit ndërkombëtar ka një kapacitet i cili garanton ndikim dhe kontroll në institucionet shtetërore, gjë e cila ndjeshëm kontribuon në forcimin dhe profesionalizimin e institucioneve të një shteti të ri siç është Kosova.

ROLI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR

Roli i faktorit ndërkombëtar në Ballkan ka qenë shumë kompleks dhe tejet i nevojshëm. Tranzicioni i vështirë dhe konfliktet etnike në Ballkan janë ndalur me intervenimin e bashkësisë ndërkombëtare. Bashkësia ndërkombëtare gjithashtu në vazhdimësi ka qenë e kyçur në asistimin e shteteve të dala nga blloku komunist për vendosjen e demokracisë dhe rendit të ri. Marrëveshjet e Dejtonit dhe të Ohrit nuk do të kishin pasur sukses pa ndërmjetësimin e tyre.³⁴¹ Bashkësia ndërkombëtare po përballet aktualisht me një shpejtësi të përshkallëzimeve të formave të ndryshme të turbullirave, në ngritjen e tensioneve nacionale, etnike, lokale, të krimit të organizuar, terrorizmit etj, forma të cilat marrin karakterin e konfliktit të cilit nganjëherë është vështirë t'i përcaktohen kufijtë e përhapjes. Në kontekst të zhvillimit të këtyre formave, përshkallëzimit, evoluimit dhe transformimit të situatave, mosmarrëveshjeve dhe tensioneve në karakterin e konfliktit, kërkohet thellësisht një formë e të menduarit pan human me të vetmin qëllim parandalimi i këtyre veprimeve të cilat kanë si prapavijë konfliktin.

Pozita gjeostrategjike të cilën e ka Kosova, duke pasur parasysh edhe kontekstin e zhvillimeve globale në rajon, e ka vendosur vendin në një pozitë të rëndësishme dhe një pikë kyçe e cila nga njëra anë mund të ndihmojë në stabilitetin e rajonit, por nga ana tjetër përbën një rrezik dhe një katalizator për konflikte të ardhshme ndëretnike, e që mund të përfshijë në vete edhe vendet e tjera të rajonit. Pas shpalljes së pavarësisë, me kërkesë të institucioneve kosovare në sensin e ndihmës, monitorimit dhe zhvillimit të institucioneve demokratike, kredibile dhe funksionale, në Kosovë funksionojnë Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO), Misioni i Unionit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX). Në fushën e sigurisë mandatar ishte KFOR-i, dhe në fushën e demokratizimit ishte pranuar prezenca e OSBE-së.

Duke u nisur nga kjo, faktori ndërkombëtar i udhëhequr nga Bashkësia Evropiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e problemeve dhe situatës politike të krijuar, në mënyrë që të krijojnë stabilitet politik – ekonomik në vend dhe mos të lejojnë shmangien e vendit nga rruget euro-atlantike dhe përfshirjen e tij në konflikte të mundshme në rajon.

Përfshirja dhe asistenca e BE-së duhet të kombinohet me një përpjekje të sinqertë të qeverive në ndërmarrjen e reformave të nevojshme në krijimin e kapaciteteve administrative të nevojshme. Në këtë kontekst, prioritet i lartë duhet të caktohet në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pasi që përparimi në këtë fushë është thelbësor në sigurimin e sundimit të ligjit, në forcimin e besimit në institucionet shtetërore, në gjenerimin e investimeve private dhe në afrimin e vendit me anëtarësimin në BE.³⁴² Prandaj, për vendet e Ballkanit Perëndimor, vende me shumë dobësi në fushat ku mbindërtimi institucional është qenësor, u krijua procesi i Stabilitetit dhe Asociimit, i cili ndërthen perspektivë për anëtarësim në UE.³⁴³ Më 1 prill 2016, hyri në fuqi Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA) në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës.

Një aspekt tjetër për të cilin mendojmë se është relevant në këtë punim, e që ka të bëjë me rolin e faktorit ndërkombëtar në zgjidhjen e procesit politik në Kosovë kanë qenë edhe rekomandimet e shumta të cilat ata i kanë shprehur në formë të raporteve të shkruara periodike, të cilat kanë pasur për qëllim identifikimin e problemeve dhe qasjen e cila duhet ndërmarrë nga aktorët për eliminimin e këtyre problemeve, të tilla si:

- politizimi i vazhdueshëm i administratës publike;
- mungesë të llogaridhënies institucionale;
- gjyqësor i cënueshëm ndaj ndikimeve politike;

³⁴¹ Carl Bildt: A Second Chance in the Balkans, në: Foreign Affairs, vëll. 80, janar/shkurt 2001, f. 148 v.

³⁴² Abdullahi, J., Bajrami, D. Political Culture in Macedonia after the Ohrid Framework Agreement, Iliria International Review, Prishtina (2012), f.157

³⁴³ Oli Ren, Kufijtë e ardhshëm të Evropës, Shkup 2007

- institucionet e sundimit të ligjit vuajnë nga mungesa e fondeve dhe burimeve njerëzore;
- korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të mbetet problem serioz.

4. KONSTATIME

Tranzicioni i stërzgatur në shtetet e Ballkanit perëndimor frenon proceset euro-integruese në rajon dhe ndikon në mënyrë negative në zhvillimin e drejtë të institucioneve shtetërore, të cilat përbëjnë edhe shtyllën kryesore të sovranitetit të një vendi. Shtetet e porsaformuara të rajonit, siç është Kosova kanë dështuar në krimin e institucioneve të besueshme dhe llogaridhënese, prandaj edhe besimi i qytetarëve ndaj këtyre institucioneve është shumë i ulët.

Prezenca e faktorit ndërkombëtar dhe e shoqërisë civile duhet të shfrytëzohet maksimalisht për ndërtimin e institucioneve kredibile dhe demokratike të cilat do të japin një mbështetje kualitative dhe do të gjejnë zgjidhje adekuate për problemet të cilat i tangojnë qytetarët.

Ndërtimi i institucioneve shtetërore kërkon përkrahje të mëtejme dhe të fuqishme përmes shkëmbimit të kuadrit profesional, investimeve të huaja në vend dhe krijimin e raporteve më të afërta me sektorin civil, duke zmadhuar fondet dhe grantet e ndryshme për projekte që kanë të bëjnë me aftësimin e nëpunësve shtetëror, pasi që vetëm me kuadro profesional mund të arrihet përmirësimi i gjendjes së krijuar nëpër institucionet shtetërore.

Edhe pse janë bërë disa përpjekje në përmirësimin e bashkëpunimit midis qeverisë dhe shoqërisë civile, sërish ekziston nevoja për shtimin e fondeve publike ndaj këtij sektori dhe eliminimin e ndikimeve politike gjatë realizimit të projekteve. Mungesa e angazhimit nga shumë ministri dhe burimet e pamjaftueshme të kapaciteteve dhe ato buxhetore pengojnë përpjekjet për zbatimin e strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe vazhdojnë të hedhin dyshime mbi vullnetin themelor politik.

Roli i faktorit ndërkombëtar është vendimtar në krijimin e kushteve kryesore për arritjen e dialogut politik, si parakusht për mirëqenien ekonomike dhe stabilitetin politik, mirëpo mungon angazhimi i tyre në zbatimin e marrëveshjeve të arritura politike nga aktorët vendor. Si pasojë e kësaj, kemi edhe zvarritjen dhe përsëritjen e marrëveshjeve me aktorët e njëjtë politik, për çështjet e njëjta politike. Qeveritë perëndimore u përpoqën të influencojnë ngjarjet në vend, por vetëm për të parandaluar konfliktet në shkallë të gjerë dhe për të siguruar respektimin e parimeve themelore demokratike, të tilla si sundimi i ligjit dhe liria e shtypit. Ata presin nga qeveritë e ardhshme të forcojnë sundimin e ligjit dhe pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e medias dhe llogaridhënien e qeverisë, pasi që stabiliteti i vendit për ta është shumë i rëndësishëm, në veçanti pas paraqitjes së krizës së emigrantëve të cilët vinin nga lindja e mesme.

Pritjet nga dialogu Prishtinë – Beograd nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian kanë për qëllim normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, në mënyrë që të lehtësohet jeta e qytetarëve dhe të krijohen parakushtet që do të çojnë në integrimin më të lehtë në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, progresi i dialogut është bërë i rëndësishëm për të ardhmen e të dy shteteve në BE. Është e qartë se Bashkimi Evropian ende do të duhet t'i afrojë të dy shtetet pranë vetës në mënyrë të kontrolluar duke pritur në shkëmbim normalizimin e marrëdhënieve, por problemi është se të dyja palët e kanë kuptuar që dialogu është i nevojshëm për shkak të rezultateve më të mira ndaj BE-së, dhe jo për shkak të një pajtimi përfundimtar të mirëfilltë me qëllim të cilësisë më të mirë jetësore për qytetarët e të dy vendeve fqinje. Normalizimi i marrëdhënieve është i rëndësishëm për BE-në për shkak të krijimit të paqes dhe stabilitetit afatgjatë në rajon.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Abdullahi, J., Bajrami, D. Political Culture in Macedonia after the Ohrid Framework Agreement, *Illiria International Review*, Prishtina (2012), f.157
- [2] Bildt, C. A Second Chance in the Balkans, në: *Foreign Affairs*, vëll. 80, janar/shkurt 2001, f. 148 v.
- [3] Fukuyama, F. Ndërtimi i shtetit, AIIS, Tiranë 2010, f.116
- [4] Instituti i Historisë Bashkëkohore, Kosova shtet i pavarur dhe sovran, Prishtinë (2006), f.180
- [5] Konrad Adenauer Stiftung, Kosova dhe marrëveshja e asocim stabilizimit, Prishtinë, 2013, f.2
- [6] Naazneen H. Barma, Elisabeth Huybens, and Lorena Viñuela (eds.) *Institutions Taking Root: Building State Capacity in Challenging Contexts*. Washington DC: World Bank, 2014.
- [7] Ren, O. Kufijt e ardhshëm të Evropës, Shkup 2007
- [8] Huntington, S. Vala e tretë, AIIS, 2011, Tiranë, f.237
- [9] Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim, Udhëzime mbi mbështetjen e Be-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit 2014-2020, Bashkimi Evropian
- [10] Dokument i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Strategji për Kosovën, Tetor 2016, F.12
- [11] Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile 2016, f.80